

PKR.nr.55/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja Valbona Musliu-Selimaj, Kryetare e trupit gjykues me procesmbajtësen Arbnore Idrizi, punëtoresh e kësaj gjykate, në çështjen penale, kundër të akuzuarve: B. V., për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK-së dhe D. V., për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, i substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.578/2016, të datës 16.02.2017, në seancën e shqyrtimit fillestar, të hapur, të mbajtur me dt.**23.02.2017**, në praninë e prokurorit të shtetit, Hivzi Bajraktari, të akuzuarve B. V., me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.M. N. dhe të akuzuarit D. V., në bazë të nenit 366 të KPPK-së, të njëjtën ditë mori dhe në prezencën e palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: B. V., nga i ati H. dhe nënës E., e vajzërisë G., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin M., Komuna e P., tani me vendbanim në P., rruga "...”pa nr., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet nën masën e paraburgimit nga data 25.10.2016 deri më datën 23.02.2017.

I akuzuari: D. V., nga i ati B. dhe nënës H., e vajzërisë B., i lindur me *data e lindjes...*, në P., ku edhe tani jeton, rruga "...”pa nr., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion taksist në firmën G., i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I akuzuari: B. V.;

I. Pa autorizim, me qëllim të shitjes apo shpërndarjes ka poseduar substancë narkotike të llojit marihuanë, me ngjyrë të gjelbër, e shpallur me ligj si narkotik, në atë mënyrë që me datën 25.10.2016, rreth orës 10:00, policia gjatë bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit në rrugën "...”, në P., në tavanin e shtëpisë ka gjetur dhe sekuestruar 19 pako të mbështjella me qese najloni, të mbushura me narkotik të dyshuar si marihuanë, me ç’rast pas ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, është vërtetuar se substanca e lartcekur përmban Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrodokanabinol, me peshë të përgjithshme prej 18.382 kg, (tetëmbëdhjetë kilogram e treqind e tetëdhjetë e dy gram),-

- me këtë ka kryer verën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK-së.

I akuzuari: D. V.;

II. Pa autorizim, ka poseduar substanca narkotike, në atë mënyrë që me datën, kohën dhe vendin e lartcekur, policia gjatë kontrollimit të shtëpisë dhe personave, në xhepin e pantallonave të tij kanë gjetur një qese të vogël me marihuanë me peshë prej 2 gram dhe në objektin përcjellës të shtëpisë së tij kanë gjetur një qese të vogël me marihuanë, me peshë prej 8 gram dhe të njëjtat janë sekuestruar nga policia,-

- me këtë ka kryer verën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, i substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 4; 7; 17; 21; 41; 42; 43; 45; 46; 73; 80 dhe 83 të KPRK-së dhe neneve 248; 359; 365 dhe 366 të KPPK-së të akuzuarit i gjykon :

Të akuzuarin **B. V.**

DËNIM ME BURGIM dhe DËNIM ME GJOBË

Dënim me **Burgim** në kohëzgjatje prej katër (4) vite e gjashtë (6) muaj dhe dënim me **Gjobë**, në shumë prej tre mijë Euro (3000 €) të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë. Koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 25.10.2016, deri me datën 23.02.2017, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar dhe nëse e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së do ti shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo njëzet euro (20 €) do ti llogaritet një ditë burg si dhe

Të akuzuarin **D. V.**

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1), viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej dy (2) viteve nuk kryen vepër tjetër penale;

Komfor nenit 62; par.2 nënpar.2.7; 69 par.1 të KPRK-së dhe nenit 282 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.2 KPPRK-së, gjykata u shqipton edhe:

DËNIM PLOTËSUES

- Konfiskohen përgjithmonë sendet e luajtshme, si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale dhe sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit dhe atë :

- Sasia e narkotikut e llojit mariohanë me peshë të përgjithshme prej 18.382 kg,

- Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajnë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimit të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej pesëdhjetë euro (50€), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Me Aktvendim të veçante PKR.nr.55/17 të datës 23.02.2017, të akuzuarit B. V. i është ndërprerë masa e paraburgimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të rënda, me aktakuzën PP.I.nr.578/2016, të dt.16.02.2017, ka akuzuar B. V., për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK-së, dhe D. V., për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, i substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 23.02.2017, ku prezantuan Prokurori i shtetit, Hivzi Bajraktari, i akuzuari B. V., me mbrojtësin e tij sipas autorizimit, Av. M. N., dhe i akuzuari D. V..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarve iu dha mundësia e deklaramit lidhur me aktakuzën të cilët deklaruan se e kanë të qartë aktakuzën dhe e pranuan fajësinë, u deklaruan fajtor të veprave penale.

I akuzuari B. V. pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij e duke i ditur pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë, e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, të cilin pranimit e bëri me vullnet të plotë dhe pa presion, shprehu keqardhje, u ndie thellë i penduar, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe premtoi se më nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

I akuzuari D. V., e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, pranimit të fajësisë e bëri me vullnet të plotë dhe pa presion e duke i ditur pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë,

shprehu keqardhje dhe u ndie thellë i penduar, se për herë të parë ka rënë në konflikt me ligjin dhe premtoi se më nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme.

Mbrojtësi i të akuzuarit, B. V., Av.M. N., deklaroi se e mbështet në tërësi pranimin e fajësisë së të akuzuarit B. V., i cili pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet dhe pa presion, e duke i ditur pasojat dhe favorët e pranimin të fajësisë i cili pranim mbështetet edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese siç, janë pranimi i fajësisë nga fillimi i procedurës penale, pendimin për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, qëndrimin korrekt, se është familjar dhe baba i tre fëmijëve, se për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin dhe gjykata të zbatojë edhe dispozitat e zbutjes së dënimit komfor neneve 74, 75 dhe 76 të KPPK-së, me propozimin që të mbrojturit të tij t'ia shqiptoj një dënim të favorshëm.

Prokurori i shteti lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë është komfor nenit 248 par. 1 të KPPK-së, dhe në përputhje edhe me provat mbi të cilat mbështetet aktakuza, i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ta aprovojë dhe të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

Pas deklarimit të të akuzuarve se ndjehen fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen nga Prokuroria dhe pas marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga prokurori i shtetit dhe mbrojtësi, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit pasi që është bindur plotësisht se ishin të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Nisur nga fakti se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, Gjykata nuk administroj prova por vlerësoj se në veprimet e të akuzuarve B. V., formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.9 të KPRK-së, dhe në veprimet e të akuzuarit D. V., formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, i substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tyre korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, pendimin e tyre për veprat e kryera penale, keqardhjen, sinqeritetin e tyre deklarues, se janë familjar, se për herë të parë kanë rënë në konflikt me ligjin, ndërsa rrethana rënduese mori intensitetin e rrezikimit, andaj të akuzuarve iu shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.2 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojnë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit sipas nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Për të akuzuarin D. V., dënimi me kusht, është risocializim i të akuzuarit me anë të pezullimit të dënimit. Me anë të këtij dënimi kryesit i tërhiqet vërejtja seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale dënimi i suspenduar për një kohë të caktuar do të ekzekutohet.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi mbi ndërprerjen e masës së paraburgimit, është marrë në bazë të nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në masën e paraburgimit është marrë në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.55/17, dt.23.02.2017

Procesmbajtësja
Arbnore Idrizi

Kryetarja e trupit gjykues
Valbona Musliu-Selimaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.